



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 468 prot.

Himarë, më 27.01.2023

VENDIM

Nr. 4 datë, 27.01.2023

PËR BASHKËFINANCIMIN E RESTAURIMIT TË BANESAVE SHUMË TË AMORTIZUARA TË FAMILJEVE NË NEVOJË NË ZBATIM TË PROJEKTIT TË STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2023

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", vendimit nr. 70, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2023" të Këshillit Bashkiak Himarë. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 27.01.2023 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë e miratoi dhe si përfundim,

VENDOSI:

1. Bashkëfinancimin e restaurimit të banesave shumë të amortizuara të familjeve në nevojë në zbatim të projektit të strehimit social për vitin 2023 sipas pikës 7 të udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019, "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret e përfitimit të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit".
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2023 dhe fondit të strehimit social që Ministria e Financave do të japë bashkive për të përballur kostot totale të projektit për përmirësimin e kushteve $\leq 70\%$ të kostos së ndërtimit të një objekti të ri referuar kostos mesatare të ndërtimit në fuqi miratuar me VKM nr.3, datë 28.12.2016 dhe referuar normave të strehimit në fuqi sipas anëtarëve të një familje bazuar në certifikatën familjare.
3. Ngarkohet drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dhe drejtoria e shërbimeve dhe mirëmbajtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

